

Shega Trans Sh.a.

**Pasqyrat financiare te konsoliduara
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
(me raportin e audituesit te pavarur)**

Përmbajtja

RAPORTI I AUDITUESIT TE PAVARUR.....	1
PASQYRA E KONSOLIDUAR E POZICIONIT FINANCIAR.....	1
PASQYRA E KONSOLIDUAR PËRMBLEDHËSE E TË ARDHURAVE	2
PASQYRA E KONSOLIDUAR E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL.....	3
PASQYRA E KONSOLIDUAR E FLUKSEVE TË PARASË	4
1. Informacion i përgjithshëm.....	5
2. Politika të rëndësishme kontabël	5
2.1 Bazat e përgatitjes.....	5
2.2 Bazat e konsolidimit.....	5
2.3 Standarde dhe interpretime të publikuara që kanë hyrë në fuqi.....	6
2.3 Standarde dhe interpretime të publikuara që kanë hyrë në fuqi (vazhdim)	7
2.3 Standarde dhe interpretime të publikuara që kanë hyrë në fuqi (vazhdim)	8
3. Gjykimet, vlerësimet dhe supozimet kontabël të rëndësishme.....	8
4. Përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël.....	9
5. Standarde dhe interpretime të publikuara por ende të pazbatuara	12
5. Standarde dhe interpretime të publikuara por ende të pazbatuara (vazhdim).....	13
6. Aktivtë afatgjata materiale.....	15
6.1 Aktivtë afatgjata jomateriale	16
7. Emri i mirë.....	16
8. Të tjera të drejta të arketueshme.....	17
9. Llogari të arketueshme	17
10. Inventari.....	17
11. Mjete monetare dhe të ngjashme	18
12. Kapitali.....	18
13. Huatë me institucionet financiare	18
14. Llogari të pagueshme dhe të tjera	19
15. Detyrime ndaj punonjesve.....	19
16. Të tjera detyrime.....	19
17. Detyrime tatimore	19
18. Të ardhurat.....	20
19. Shpenzimet e personelit	20
20. Shpenzime për taksat të ndryshme	20
21. Shpenzime mirembajtje dhe riparimi	20
22. Shpenzime të tjera operative.....	21
23. Qera, uje dhe energji.....	21
24. Shpenzime financiare.....	21
25. (Humbje)/Fitim nga kursi i këmbimit, neto	21
26. Shpenzime tatim fitimi.....	21
27. Menaxhimi i Rrezikut Financiar	22
28. Angazhime dhe kushtëzime	25
29. Ngjarjet pas datës së raportimit	25



Raporti i Audituesit të Pavarur

Për drejtimin dhe aksionarët e shoqërisë Shega Trans sh.a,

Opinion i modifikuar (me rezerve)

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të shoqërisë Shega Trans sh.a. (më poshtë “Grupi”) që përmbajnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 Dhjetor 2016, pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave, pasqyrën e ndryshimit të kapitalit, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në këtë datë, dhe një përmbledhje të politikave kontabile dhe informacione të tjera sqaruese.

Sipas opinionit tonë, përvec efekteve të mundshme të cështjeve të diskutuara në paragrafin “Bazat për Opinionin e Modifikuar”, pasqyrat financiare të Shega Trans sh.a. paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Grupit më 31 Dhjetor 2016, performancën e tij financiare dhe fluksit e mjeteve monetare dhe ndryshimet në kapital, në përputhje me Standartet Ndërkombetare të Raportimit Financiar.

Bazat per opinionin e modifikuar

Siç është paraqitur në Shënimin 7 të pasqyrave financiare më 31 Dhjetor 2016 vlera e Emrit te mire te rezultuar nga blerja e shoqerive Albaskan, Shega Oil, Shega Air dhe Shega Podgorice nuk është testuar nga drejtimi për rënie vlere sikurse kërkohet nga standartet ndërkombëtare të raportimit financiar SNRF SNRF 36).

Siç është paraqitur në Shënimin 10 të pasqyrave financiare më 31 Dhjetor 2016 vlera e inventarit është 79,107,723 Lekë. Ne nuk kemi vëzhguar inventarizimin fizik të inventarit më 31 Dhjetor 2016 meqenëse kjo datë ka qenë para se ne të angazhoheshim si auditues të Grupit dhe për shkak të natyrës së biznesit nuk ishim në gjendje që me mënyra alternative të siguronim evidencë të mjaftueshme për të konfirmuar vlerën e inventarit gjendje më 31 Dhjetor 2016.

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standarteve janë përshkruar në mënyrë të detajuar në paragrafin **Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare** të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Grupi në përputhje me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standarteve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (Kodi I BSNEPK) së bashku me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe te Kodit BSNEPK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë të modifikuar.

TPA Albania shpk

Rr.Reshit Collaku, Pall.Shallvare, Apt.44, 1000 Tirana, Albania

www.tpa-group.com

Përgjegjësitë e drejtimit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e sinqertë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), dhe për ato kontrolle të brendshme, të cilat drejtimi i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare që janë pa pasaktësi materiale, si pasojë e mashtrimit apo gabimeve.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Grupit për të vazhduar aktivitetin e tij në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuidojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveç sa më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Grupit.

Përgjegjësia e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

TPA Albania shpk

Rr.Reshit Collaku, Pall.Shallvare, Apt.44, 1000 Tirana, Albania

www.tpa-group.com

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shega Trans sh.a., përveç çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

Datë 30 Qershor 2017

Laura Gjinali, Auditues Ligjesh

A handwritten signature in blue ink is written over a circular blue stamp. The stamp contains the text "AUDIT • ADVISORY" at the top, "tpa" in the center, and "ALBANIA" at the bottom.

TPA Albania shpk
Rr.Reshit Collaku, Pall.Shallvare, Apt.44, 1000 Tirana, Albania
www.tpa-group.com

Albania | Austria | Bulgaria | Croatia | Czech Republic | Hungary | Poland | Romania | Serbia | Slovakia | Slovenia

PASQYRA E KONSOLIDUAR E POZICIONIT FINANCIAR
Më 31 dhjetor 2016

	Shënime	31 Dhjetor 2016 në Lekë	31 dhjetor 2015 në Lekë
Aktive			
Aktive afatgjata			
Aktivet afatgjata materiale	6	722,340,207	657,760,187
Aktivet afatgjata jomateriale	6.1	6,027,094	4,988,458
Emri i mire	7	56,395,164	56,395,164
Të tjera të drejta për tu arkëtuar		622,133	622,133
Total - Aktive afatgjata		785,384,598	719,765,942
Të tjera të drejta të arketueshme	8	73,391,110	111,666,212
Llogari të arketueshme	9	247,055,801	185,207,534
Inventari	10	79,107,723	71,044,358
Mjete monetare dhe të ngjashme	11	13,058,383	14,991,014
Total – Aktive afatshkurtra		412,613,017	382,909,118
TOTAL AKTIVE		1,197,997,615	1,102,675,060
Kapitali dhe Detyrimet			
Kapitali aksionar			
Rezerva ligjore		104,097,655	104,097,655
Fitimi i pashperndare		8,481,707	8,481,707
Total – Kapitali	12	117,008,606	(21,851,726)
Detyrime afatgjata			
Huatë nga institucionet financiare	13	194,116,049	271,457,809
Total - Detyrime afatgjata		194,116,049	271,457,809
Detyrime afatshkurtra			
Llogari te pagueshme dhe te tjera	14	282,765,196	214,739,033
Huatë nga institucionet financiare	13	333,614,790	345,606,243
Detyrime ndaj punonjesve	15	13,907,037	9,576,171
Te tjera detyrime	16	109,295,216	160,477,413
Detyrime tatimore	17	34,711,359	10,090,755
Total - Detyrime afatshkurtra		774,293,598	740,489,615
Total - Detyrime		968,409,647	1,011,947,424
TOTAL KAPITALI DHE DETYRIMET		1,197,997,615	1,102,675,060

Këto pasqyra financiare te konsoliduara dhe shënimet shoqëruese nga 1 deri në 29, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare te konsoliduara, janë autorizuar nga drejtimi më 28 Qershor 2017 dhe nëshkruar në emër të tij nga:

Administrator

Ervin SHIJAKU

Ervin Shijaku



PASQYRA E KONSOLIDUAR PËRMBLEDHËSE E TË ARDHURAVE
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016

Shënime	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2016 në Lekë	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2015 në Lekë
Të ardhura nga operacionet	2,181,799,955	1,863,583,495
Të ardhura të tjera	7,426,297	20,286,014
Total të ardhura	2,189,226,252	1,883,869,509
Blerje karburanti	(439,877,586)	(446,568,280)
Materiale te konsumuara	(85,864,276)	(40,966,299)
Shpenzime spedicioni	(654,388,699)	(526,080,570)
Shpenzime për personelin	19 (326,426,144)	(301,218,818)
Amortizimi dhe zhvlerësimi	6, 6.1 (138,943,558)	(137,202,161)
Shpenzime per taksa te ndryshme	20 (106,035,144)	(107,268,783)
Shpenzime mirembajtje dhe riparimi	21 (20,378,223)	(47,715,736)
Shpenzime të tjera operative	22 (124,393,476)	(210,584,125)
Qera, uje , energji	23 (76,541,987)	(63,820,399)
Fitimi operacional	216,377,159	2,444,338
Shpenzime financiare	24 (44,178,214)	(54,502,710)
(Humbje)/Fitim nga kursi i këmbimit, neto	25 7,251,585	10,259,043
Të ardhura/(shpenzime) financiare, neto	(458,639)	(493,036)
Fitimi para tatimit	178,991,891	(42,292,365)
Tatimi mbi fitimi	26 (40,131,559)	(16,065,088)
(Humbja)/Fitimi neto për vitin	138,860,332	(58,357,453)
Të ardhura të tjera përmbledhëse	-	-
(Humbja)/Fitimi përmbledhës për vitin	138,860,332	(58,357,453)

Shënimet shoqëruese mbi Pasqyrat financiare te konsoliduara të konsoliduara nga 1 në 29 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare te konsoliduara.

SHEGA TRANS SH.A.*(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***PASQYRA E KONSOLIDUAR E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

	Kapital aksionar	Rezervat	Fitimi i	Totali
	në Lekë	statutore/ligjore	pashperndare	në Lekë
		në Lekë	në Lekë	
Gjendja më 1 Janar 2014	104,097,655	8,481,707	36,505,727	149,085,089
Fitimi i vitit	-	-	(58,357,453)	(58,357,453)
Të ardhura të tjera përmbledhëse	-	-	-	-
Totali i të ardhurave përmbledhëse	-	-	(58,357,453)	(58,357,453)
Gjendja më 31 dhjetor 2015	104,097,655	8,481,707	(21,851,726)	90,727,636
Fitimi i vitit	-	-	138,860,332	138,860,332
Të ardhura të tjera përmbledhëse	-	-	-	-
Totali i të ardhurave përmbledhëse	-	-	138,860,332	138,860,332
Gjendja më 31 dhjetor 2016	104,097,655	8,481,707	117,008,606	229,587,968

Shënimet shoqëruese mbi Pasqyrat financiare të konsoliduara të konsoliduara nga 1 në 29 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

SHEGA TRANS SH.A.*(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)***PASQYRA E KONSOLIDUAR E FLUKSEVE TË PARASË****Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016**

		Viti mbyllur më 31 dhjetor 2016 në Lekë	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2015 në Lekë
Aktivitetet operative			
Të ardhurat pas tatimit		138,860,332	(58,357,453)
Korrigjime mbi humbjen neto për të përfituar flukset monetare nga aktiviteti operativ:			
Zhvlerësimi dhe amortizimi	6,6.1	138,943,558	137,202,161
Rimarrje amortizimi per aktivet e shitura	6	(40,842)	(21,890,461)
Dalje te aktiveve te shitura	6	558,020	72,699,781
Shpenzime (të ardhura) nga interesat neto		44,178,214	54,502,710
Rregullimet e kapitalit punues			
(Rritje)/Zvogëlim në të drejta ndaj klienteve	11	(61,848,267)	63,932,116
(Rritje)/Zvogëlim në të tjera te drejta te arketueshme	8,9,10	38,275,102	57,023,442
(Rritje)/Zvogëlim në inventar	12	(8,063,365)	(6,054,825)
Rritje/(Zvogëlim) në llogari të pagueshme dhe te tjera	16	68,026,163	(74,134,753)
Rritje/(Zvogëlim) në detyrime të tjera	17,18,19	(22,230,727)	101,513,692
Interesi neto (i paguar)		(44,178,214)	(54,502,710)
Mjetet monetare neto të (përdorura)/përfituara nga aktivitetet e shfrytëzimit		292,479,974	271,933,700
Aktivitetet investuese			
Blerja e aktiveve, neto nga shitja	6	(205,082,123)	(180,715,424)
Hyrje jo cash per efekt konsolidimi	6	2,731	(11,164,659)
Mjetet monetare neto të përdorura në aktivitetet investuese		(205,079,392)	(191,880,083)
Aktivitetet financuese			
Të hyra nga huamarrjet, neto nga pagesat	15	(89,333,213)	(78,562,201)
Mjetet monetare neto të përfituara në aktivitetet financiare		(89,333,213)	(78,562,201)
Pakesimi neto i mjeteve monetare		(1,932,631)	1,491,416
Mjete monetare në fillim të periudhës		14,991,014	13,499,598
Mjete monetare në fund të periudhës	13	13,058,383	14,991,014

Shënimet shoqëruese mbi Pasqyrat financiare te konsoliduara të konsoliduara nga 1 në 29 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare te konsoliduara.

SHEGA TRANS SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE TE KONSOLIDUARA
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2016

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

1. Informacion i përgjithshëm

Shega Trans Sh.A (e quajtur më tej “Grupi”) është një shoqëri aksionere transporti regjistruar në Regjistrin Tregtar në Tiranë, datë 13.01.2005 me vendim të Gjykatës së Tiranës dhe ka NIPT K51504004P, regjistruar në QKR me seli qendrore Tiranë Rruga Ali Kelmendi, ish Kombinati i Tekstileve.

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë konsiston në Transport ndërkombëtar mallrash, agjensi detare, agjensi spedicionere etj, Transport kombëtar dhe ndërkombëtar të pasagjereve për të tretë dhe për nevoja të vet shoqërisë, Agjensi për shitje biletash transporti ndërkombëtar dhe brenda vendit të udhëtareve. Transport të udhëtareve në linja urbane dhe interurbane.

Me 18 dhjetor 2013 janë blerë 100 kuota me vlerë nominale 1,000 leke për kuota të shoqërisë Shega Oil (NIPT: L12213022C) për një vlerë prej 100,000 leke. Me 27 dhjetor 2013 shoqëria ka bërë rritjen e kapitalit tek shoqëria e investuar me emetimin e 1,000 kuotave të reja me një vlerë nominale prej 25,500 leke kuota, duke e çuar vlerën totale të kapitalit të zotuar në këtë shoqëri (100% të kuotave) në 25,600,000 leke. Me 28 dhjetor 2015 shoqëria ka bërë rritjen e kapitalit tek shoqëria e investuar me një vlerë prej 12,000,000 leke, duke e çuar vlerën totale të kapitalit të zotuar në këtë shoqëri (100% të kuotave) në 37,600,000 leke dhe duke kthyer numrin e kuotave nga 100 në 1.

Me 18 dhjetor 2013 janë blerë 100 kuota me vlerë nominale 253,000 leke për kuota të shoqërisë Albaskan (NIPT: L11810011L) për një vlerë prej 25,300,000 leke. Me 27 dhjetor 2013 shoqëria ka bërë rritjen e kapitalit tek shoqëria e investuar me emetimin e 100 kuotave të reja me një vlerë nominale prej 170,000 leke kuota, duke e çuar vlerën totale të kapitalit të zotuar në këtë shoqëri (100% të kuotave) në 42,300,000 leke. Me 28 dhjetor 2015 shoqëria ka bërë rritjen e kapitalit tek shoqëria e investuar me një vlerë prej 44,700,000 leke, duke e çuar vlerën totale të kapitalit të zotuar në këtë shoqëri (100% të kuotave) në 87,000,000 leke dhe duke kthyer numrin e kuotave nga 100 në 1.

Me 03 qershor 2014 shoqëria ka investuar në masën 100%, 100,000 leke (100 kuota) në shoqërinë Shega Air (NIPT: L41803004T). Me 16 Mars 2015 shoqëria ka investuar edhe në Shoqërinë Shega Trans Podgorice në vlerën 1 EUR (140 leke) kapital themeltar.

2. Politika të rëndësishme kontabël

2.1 Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit janë përgatitur në bazë të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”) të hartuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

Pasqyrat financiare të konsoliduara janë përgatitur në bazë të kostos historike.

Pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit janë përgatitur në Lekë shqiptar (“Lekë”), e cila është edhe monedha kryesore e mjedisit ekonomik ku operon Grupi (shiko gjithashtu shënimin 3.a).

Aktivitetet financiare dhe detyrimet financiare janë të kompensuar dhe shumat neto raportohen në pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar vetëm kur ka të drejtë ligjore për t’i kompensuar shumat e njohura dhe ka një përpjekje për t’i vendosur në bazë neto, ose për realizimin e aktiveve dhe shlyerjen e detyrimeve njëkohësisht. Të ardhurat dhe shpenzimet nuk janë të kompensuara në pasqyrën e konsoliduar të të ardhurave përmbledhëse pasi nuk kërkohet ose lejohet nga ndonjë standard i kontabilitetit ose interpretim, dhe ndonjë politikë kontabël e Grupit.

2.2 Bazat e konsolidimit

Pasqyrat financiare të konsoliduara përfshijnë pasqyrat financiare të Grupit dhe filialeve të tij me 31 dhjetor 2016.

Konsolidimi i filialeve fillon kur Grupi merr kontrollin dhe mbaron kur Grupi e humbet këtë kontroll mbi filialin. Aktivitetet, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e filialit të blerë ose të shitur gjatë vitit përfshihen në pasqyrat financiare të konsoliduara nga data që Grupi merr kontrollin deri në datën kur Grupi e humbet atë.

Te gjitha të drejtat dhe detyrimet, dhe aktivitetet, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet dhe flukset e parase ndërmjet shoqërive të Grupit eliminohen në konsolidim.

SHEGA TRANS SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE TE KONSOLIDUARA
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2016

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

2.3 Standarde dhe interpretime të publikuara që kanë hyrë në fuqi

Politikat kontabël të aplikuara janë në përputhje me politikat e vitit financiar të mëparshëm me perjashtim të SNRF-ve të ndryshuara, të cilat janë adoptuar nga Shoqëria në datën 1 janar 2016:

- **SNRF 14 Llogarite e Shtyra për Efekte Rregullatore**
- **SNRF 11 Marreveshjet e perbashketa (Ndryshuar): Kontabiliteti i Blerjes së Interesave në Operacione të Perbashketa**
- **SNK 16 Aktive Afatgjata Materiale dhe dhe SNK 38 Aktivët jo-Materiale (Ndryshuar): Qartësimi i Metodave të Pranueshme të Zhvlerësimit dhe Amortizimit**
- **SNK 16 dhe SNK 41 Bujqësi: Bimet Prodhuese (Ndryshuar)**
- **SNK 27 Pasqyrat Financiare Individuale (Ndryshuar)**
- **Permirësimet Vjetore për SNRF-të Ciklit 2012 – 2014**
- **SNK 1: Iniciative e Shenimeve Shpjeguese (Ndryshuar)**
- **SNRF 10, SNRF12 dhe SNK 28: Subjektet Investuese: Aplikimi i Perjashtimit nga Konsolidimi (Ndryshuar)**

Këto ndryshime në standardet ekzistuese dhe interpretimet nuk kanë ndikuar në politikat kontabël të Grupit. Natyra dhe ndikimi i çdo standardi dhe ndryshimi është përshkruar si vijon:

- SNRF 14 Llogarite e Shtyra për Efekte Rregullatore

SNRF 14 është një standard opsional që i lejon subjektet aktivitetet e të cilave janë subjekt i rregullimit të tarifave, të vazhdojnë aplikimin e politikave kontabile ekzistuese për balancat e llogarive e shtyra rregullatore gjatë adoptimit për herë të parë të IFRS-ve. Entitetet që adoptojnë SNRF 14 duhet të prezantojnë llogarite e shtyra rregullatore vecmas nga zërat e tjera në pasqyrën e pozicionit financiar dhe të shfaqin levizjet në këto llogari vecmas nga zërat e tjera në pasqyrën e fitimit humbjes and të të ardhurave gjithëpërfshirëse.

Standardi kërkon që shenimet shpjeguese të sqarojnë natyrën dhe riskun e lidhur me tarifat e rregulluara të entitetit dhe efektet e tyre në pasqyrat financiare. Meqenëse Grupi është një përgatitese e pasqyrave sipas SNRF-ve dhe nuk është e përfshirë në ndonjë aktivitet me tarifa të rregulluara nga agjensi shtetërore, ky standard nuk është i aplikueshem.

- SNRF 11 Marreveshjet e perbashketa (Ndryshimi): Kontabiliteti i Marrjes së Interesave në Operacione të Perbashketa

Ndryshimi i SNRF 11 kërkon që kontabiliteti i një operatori të perbashket që investon në një tjetër operator të perbashket i cili përben një biznes duhet të aplikojë principet dhe kontabilitetin e SNRF 3 Kombinimet e Biznesit. Standardi sqaron se një investim i mëparshëm në një operacion të perbashket nuk rimatet edhe kur investimi rritet në të njëjtin operacion të perbashket për sa kohë që kontrolli i perbashket nuk ndryshon. Gjithashtu amendimi i SNRF 11 sqaron se nuk aplikohet për palet të cilat kanë kontroll të perbashket në një operacion duke përfshirë entitetin raportues, të cilat janë të kontrolluara nga një pale tjetër. Amendimet janë të aplikueshme si për blerjen e investimeve fillestare në operacionet e perbashketa ashtu edhe për blerjen e çdo investimi shtesë në të njëjtin operacion të perbashket dhe zbatohen në mënyrë prospektive. Këto ndryshime nuk kanë ndikim tek Grupi pasi nuk ka pasur asnjë investim në një operacion të përbashkët gjatë periudhës.

- SNK 16 Aktive Afatgjata Materiale dhe dhe SNK 38 Aktivët jo-Materiale (Ndryshimi): Qartësimi i Metodave të Pranueshme të Zhvlerësimit dhe Amortizimit

Ky ndryshim sqaron parimin e SNK 16 Aktive Afatgjata Materiale dhe SNK 38 Aktivët Jo-materiale, ku të ardhurat pasqyrojnë një model të përfitimeve ekonomike që janë të gjeneruara nga veprimtaria e një biznesi (ku aktivi bën pjesë) në vend të përfitimeve ekonomike që konsumohen përmes përdorimit të aktivitetit. Si rezultat, raporti i të ardhurave i krijuar mbi të ardhurat e përgjithshme të pritshme për t'u gjeneruar nuk mund të përdoret për të zhvlerësuar aktivitet afatgjata materiale, por mund të përdoret vetëm në raste shumë të rralla për të amortizuar aktivitet jo-materiale. Amendimet aplikohen në mënyrë prospektive dhe nuk ndonjë impakt tek Grupi pasi nuk përdor metode amortizimi të bazuar mbi të ardhurat.

SHEGA TRANS SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE TE KONSOLIDUARA
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2016

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

2.3 Standarde dhe interpretime të publikuara që kanë hyrë në fuqi (vazhdim)

- SNK 16 dhe SNK 41 Bujqesi: Bimet Prodhuese (Ndryshimi):

Amendimet ndryshojnë kërkesat e kontabilitetit për aktivet biologjike që plotesojnë perkufizimin e bimeve prodhuese. Sipas ndryshimeve, aktivet biologjike që plotesojnë perkufizimin e bimeve prodhuese nuk do të jenë brenda objektit të SNK 41. Në vend të kësaj, SNK 16 do të zbatohen. Pas njohjes fillestare, bime prodhuese do të matet në bazë të SNK 16 me kosto të akumuluar (para maturimit) duke përdorur ose modelin e koston ose modelin e rivleresimit (pas maturimit). Ndryshimet gjithashtu kërkojnë që prodhimi që rritet në bimët prodhuese do të mbetet në objektin e SNK 41 i matur me vlerën e drejtë minus kostot për shitje. Për grantet qeveritare të lidhura me bimët prodhuese, SNK 20 Kontabiliteti për Grantet Qeveritare dhe Dhenia e Informacioneve Shpjeguese për Ndihmen Qeveritare do të zbatohet. Ndryshimet do të aplikohen në mënyrë retrospektive për periudhat vjetore që fillojnë me ose pas 1 janarit 2016, duke lejuar adoptim me të hershem. Këto ndryshime nuk priten të ketë ndonjë ndikim pasi Grupi nuk ka bime prodhuese si asetë.

- SNK 27 Pasqyrat Financiare Individuale (Ndryshuar)

Këto ndryshime lejojnë entitetin të përdorë metodën e kapitalit për të kontabilizuar investimet në filiale, pjesëmarrje të përbashkëta dhe pjesëmarrjet në pasqyrat financiare individuale. Entitetet që aplikojnë momentalisht SNRF dhe kërkojnë të ndryshojnë në metodën e kapitalit në pasqyrat e tyre individuale duhet ta aplikojnë këto ndryshime në mënyrë retrospektive. Këto ndryshime nuk kanë ndonjë ndikim në pasqyrat financiare të Grupit pasi Grupi i kontabilizon me metodën e kapitalit investimet e tij në filiale.

- Përmirësime vjetore të SNRF-ve, Cikli 2012-2014

Këto përmirësime përfshijnë:

- SNRF 5 – Aktivët afatgjatë të mbajtura për shitje dhe operacionet jo të vijueshme: Aktivët (ose Shoqëritë për tu nxjerrë në hitje) përgjithësisht nxirren nga librat kontabel ose nepermjet shitjes së tyre ose shpërndarjes së tyre tek pronarët. Ndryshimi sqaron se kalimi nga një plan nxjerrje jashtë tek tjetri nuk konsiderohet një plan i ri nxjerrje jashtë librave kontabel, por një vazhdim i planit ekzistues. Në këtë kuptim nuk ka ndërprerje të aplikimit të kërkesave të SNRF 5. Ky ndryshim aplikohet në mënyrë prospektive.

- SNRF 7 – Instrumentat financiarë: Shenimet shpjeguese

(i) Kontratat e shërbimit

Ky ndryshim sqaron se kontratat e shërbimit që përfshijnë tarifa mund të përfaqësojnë përfshirje të vazhdueshme në një aktiv financiar. Entiteti duhet të vlerësojë natyrën e tarifës dhe angazhimit, përkundërt orientimit të përfshirjes së vazhdueshme të SNRF 7 me qëllim që të vlerësohet nëse janë të nevojshme shenimet shpjeguese. Vlerësimi për të cilin kontrata e shërbimit përfaqëson një përfshirje të vazhdueshme duhet të bëhet në mënyrë retrospektive. Sidoqoftë, shenimet shpjeguese nuk është e nevojshme të jepen për periudhat të cilat fillojnë përpara vitit në të cilin entiteti aplikon për herë të parë ndryshimet.

(ii) Aplikueshmëria e ndryshimeve të SNRF 7 për pasqyrat financiare të ndërmjetme të përmbledhura. Ndryshimi sqaron se kërkesat për shenimet shpjeguese për netimin, nuk aplikohen për pasqyrat financiare të ndërmjetme të përmbledhura, përveç rasteve kur shenimet shpjeguese japin një informacion të rëndësishëm në lidhje me informacionin e raportuar në raportin me të fundit vjetor. Ky ndryshim aplikohet në mënyrë retrospektive.

- SNK 19 – Perfitimet e punonjësve: Ndryshimi sqaron që thellesia tregtare e obligacioneve të korporatave me cilësi të lartë vlerësohet bazuar në monedhën në të cilën është obligacioni, me shumë se sa nga shteti ku ndodhet ky obligacion. Kur nuk ka një treg aktiv për obligacione të korporatave me cilësi të lartë në atë monedhë, duhet të përdoren obligacionet qeveritare. Ky ndryshim aplikohet në mënyrë prospektive.

- SNK 34 – Raportimi financiar i ndërmjetem: Ndryshimi sqaron se shenimet shpjeguese të ndërmjetme duhet ose të jenë në pasqyrat financiare të ndërmjetme ose të përfshihen nepermjet kryqezimit të informacionit ndërmjet pasqyrave financiare të ndërmjetme dhe cdo vendi tjetër në të cilin ato janë përfshirë në raportin financiar të ndërmjetem (p.sh., në raportin e riskut apo raportin e manaxhimit). Informacioni tjetër në raportin financiar të ndërmjetem duhet të jetë në dispozicion të

SHEGA TRANS SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE TE KONSOLIDUARA
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2016

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

perdoruesve me te njejtat kushte si dhe pasqyrat financiare te ndermjetme si dh ene te njejtën kohe. Ky ndryshim aplikohet ne menyre retrospektive. Keto ndryshime nuk kane ndikim per Grupin.

2. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

2.3 Standarde dhe interpretime të publikuara që kanë hyrë në fuqi (vazhdim)

- **Ndryshimet ne SNK 1 – Paraqitja e shënimeve shpjeguese:** Ndryshimet në SNK 1 Paraqitja e Pasqyrave Financiare sqarojnë sesa ndryshojnë në mënyrë të konsiderueshme kërkesat ekzistuese të SNK 1. Ndryshimet qartësojnë:
 - o Materialitetin sipas kërkesave të SNK 1
 - o Rreshtat specifik mund të ndahen në pasqyrën e fitim, humbjeve dhe të ardhurave të tjera dhe në pasqyrën e pozicionit financiar,
 - o Subjektet kanë fleksibilitet për sa i përket rendit në të cilën ata paraqesin shënime për pasqyrat financiare
 - o Pjesa e të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse të pjesëmarrjeve dhe sipërmarrjeve të përbashkëta të kontabilizuara duke përdorur metodën e kapitalit neto duhet të paraqiten si një zë në total, dhe të klasifikuar mes atyre artikujve që do apo nuk do të jenë më pas të riklasifikuar në fitim ose humbje
 - o Për më tepër, ndryshimet qartësojnë kërkesat që zbatohen kur nëntotale shtesë janë paraqitur në pasqyrën e pozicionit financiar dhe deklaratën / deklaratat e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera. Këto ndryshime nuk pritet të ketë ndonjë ndikim për Grupin.

Ndryshime ne SNRF 10, SNRF 12 dhe SNK 28 Entitetet Investuese: Aplikimi për shmangie nga konsolidimi: Ndryshimet adresojnë çështje të cilat janë ngritur në aplikimin e shmangies së shoqerive investuese sipas SNRF 10 Pasqyrat Financiare të Konsoliduara. Ndryshimet në SNRF 10 sqarojnë se shmangia nga prezantimi i pasqyrave financiare të konsoliduara është i aplikueshem për një shoqeri mëmë e cila është filial i një entiteti investues, kur entiteti investues mat të gjithë filialet e saj me vlerë të drejte. Për më tepër, ndryshimi në SNRF 10 sqaron se vetëm një filial i një entiteti investues që nuk është në vetvete një entitet investues dhe që jep shërbime mbështetëse entitetit investues konsolidohet. Të gjithë filialet e tjera të entitetit investues maten me vlerë të drejte. Ndryshimet në SNK 28 Investimet në Pjesëmarrje dhe Siperarrjet e Përbashkëta lejojnë investitorin, kur aplikohet metoda e kapitalit, të mbajë vlerën e drejte të aplikuar nga entiteti investues për interesin e tij në filiale. Këto ndryshime aplikohen në mënyrë retrospektive dhe nuk kanë ndikim për Shoqerine pasi Shoqeria nuk përdor shmangien nga konsolidimi.

3. Gjykimet, vlerësimet dhe supozimet kontabël të rëndësishme

Përgatitja e pasqyrave financiare të konsoliduara në përputhje me SNRF kërkon që Drejtimi të bëjë disa gjykime, vlerësime dhe supozime, të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe në raportimin e vlerave të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara.

Vlerësimet dhe supozimet themelore rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi kryhet dhe në ndonjë periudhë të ardhshme, në të cilën ato ndikojnë. Informacion mbi elementë të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykimeve kritike për aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt të rëndësishëm në vlerat e njohura në Pasqyrat financiare të konsoliduara janë paraqitur më poshtë.

Tatimi mbi fitimin

Grupi është subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Një gjykim i rëndësishëm është kërkuar për të përcaktuar vlerat e tatimit fitimit të shtyrë. Ka transaksione dhe llogaritje për të cilat përcaktimi përfundimtar i tatimit është i pasigurtë. Grupi njih detyrimet për çështjet e parashikuara tatimor të auditimit bazuar në vlerësimin nëse do të ketë shtesa në taksë. Kur rezultati përfundimtar tatimor ndryshon në mënyrë të rëndësishme me shumatat të cilat kanë qenë regjistruar fillimisht, diferenca të tilla do të ndikojnë në tatim fitimit aktual dhe të shtyrë dhe detyrimet në periudhën në të cilën është bërë një vlerësim i tillë.

Përcaktimi i vlerës së drejtë

Nuk ka politika të rëndësishme kontabël të adoptuara nga Grupi të cilat kërkojnë përcaktimin e vlerës së drejtë, për aktivet dhe detyrimet financiare dhe jo financiare. Vlera e drejtë është përcaktuar për qëllime të informacioneve shpjeguese të bazuara në metodat e mëposhtme. Kur janë të aplikueshme, informacione rreth supozimeve të bëra në përcaktimin e vlerës së drejtë paraqiten në shënime specifike të aktiveve ose detyrimeve.

SHEGA TRANS SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE TE KONSOLIDUARA
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2016

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

4. Permbledhje të politikave të rëndësishme kontabël

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë aplikuar nga Grupi në mënyrë konsistente për të gjithë periudhën të paraqitur në pasqyrat financiare të konsoliduara.

(a) Kombinimi i biznesit dhe emri i mire

Kombinimi i biznesit kontabilizohet sipas metodës së blerjes. Kosto e një blerjeje matet si agregat i fluksit dales të transferuar të matur në datën e blerjes me vlerën e drejte dhe vlerës së pakicës jokontrrolluese nëse do të kete të tilla. Për çdo konsolidim biznesi Grupi zgjedh nëse do të marrë interesin e pakicës jokontrrolluese me vlerë të drejte apo në proporcion me pjesën e zotëruar në biznes të aktiveve neto.

Kostot e lidhura me blerjen kalojnë në shpenzim kur ndodhin dhe përfshihen në shpenzimet administrative.

Emri i mire njihet fillimisht me kosto, që është vlera që tejkalon fluksin dales me aktivet neto të biznesit të zotëruar pasi është zbritur pjesa që i takon interesit të pakicës jokontrrolluese. Me pas emri i mire llogaritet me kosto minus zhvlerësimin.

(b) Transksionet në monedhë të huaj

Rregjistrimet kontabël të njësisë janë të përgatitura në Lekë Shqiptar, e cila është edhe monedha kryesore e mjedisit ekonomik në të cilën operon Grupi

Gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare, transaksionet në monedhë të ndryshme nga monedha funksionale (monedha të huaja) rregjistrohen me kursin e këmbimit të datës së transaksionit. Në fund të çdo periudhe raportuese, mjetet monetare në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin e datës së raportimit. Mjetet jo monetare që mbahen me vlerë të drejtë që janë të rregjistruara në monedhë të huaj, rivlerësohen në kursin e datës kur përcaktohet vlera e drejtë. Mjetet jo monetare që maten me kosto historike në monedhë të huaj nuk rivlerësohen.

Diferencat nga këmbimi njihen në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse si fitim apo humbje në periudhën në të cilën ata ndodhin përveç diferencave të këmbimeve për huamarrjet në monedhë të huaj të lidhura me aktivet në ndërtim për përdorim të ardhshëm, të cilat përfshihen në kostot e atyre aktiveve kur ato lidhen me një rregullim në koston e interesit të huamarrjeve në monedhë të huaj.

(c) Instrumentat financiarë

Grupi fillimisht i ka njohur llogaritë e arkëtueshme dhe depozitat në datën e krijimit të tyre. Të gjitha aktivet e tjera financiare (duke përfshirë edhe aktivet e vlerësuar me vlerën e drejtë) njihen në datën e tregtimit, datën kur shoqëria ka lidhur një kontratë për këto instrumenta. Grupi ç'rregjistron një aktiv financiar në momentin kur të drejtat kontraktuale për flukset nga këto aktive skadojnë, ose transferon të gjitha të drejtat për të përfituar flukset kontraktuale të të ardhurave të aktivitetit financiar me anë të një transaksioni, i cili transferon përfitimet dhe rreziqet që lidhen me pronësinë e aktivitetit. Ndonjë interes që është mbajtur apo krijuar mbi aktivet e transferuara nga Grupi paraqitet më vete si një e drejtë apo detyrim. Detyrimet dhe të drejtat financiare kompesohen dhe paraqiten me vlerën neto në bilanc, vetëm kur Grupi ka të drejtën ligjore për të kompensuar vlerat dhe ka për qëllim të shlyejë këto në vlerë neto, apo të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht. Instrumentat financiarë joderivativë të shoqërisë përfshijnë të drejtat të tregtueshme dhe të tjera, mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj, detyrime të tregtueshme dhe të tjera.

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj përfshijnë para në arkë dhe llogaritë rrjedhëse bankare.

Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme fillimisht shprehen me vlerë të drejtë dhe në vazhdimësi maten me kosto të amortizuara duke përdorur metodën e normës efektive të interesit minus humbjet nga zhvlerësimi.

Huatë nga Institucionet Financiare

Huatë e marra nga Institucionet Financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë, duke zbritur koston e transaksionit. Detyrimet financiare maten më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv, duke njohur shpenzimin e interesit mbi bazën e interesit efektiv.

Metoda e normës efektive të interesit është një metodë për llogaritjen e koston të amortizuar të një detyrimi financiar dhe për alokimin e shpenzimeve të interesit përgjatë periudhës. Norma efektive e interesit është norma e cila skanton ekzaktësisht pagesat e ardhshme të vlerësuar përgjatë jetës së pritshme të detyrimit financiar, ose, ku është e përshtatshme, për një periudhë më të shkurtër.

SHEGA TRANS SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE TE KONSOLIDUARA
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2016

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

4. Përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(c) Instrumentat financiare (vazhdim)

Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme fillimisht shprehen me vlerë të drejtë dhe në vazhdimësi maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit.

Të tjera

Instrumenta të tjera financiare jo derivative janë matur me koston e amortizueshme, duke përdorur metodën e normës së interesit efektive, duke zbritur humbjet nga zhvlerësimet.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme janë klasifikuar si kapital.

(d) Aktive afatgjata materiale

Njohja dhe matja

Aktivitet afatgjata materiale, maten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga zhvlerësimi. Kostot përfshijnë shpenzimet që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejte me blerjen e aktivitet. Kostoja e aktiveve të ndërtuara nga vetë Grupi përfshin koston e materialeve dhe punës direkte dhe kosto të tjera që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë për sjelljen e aktivitet në gjëndje pune për qëllimin që i është caktuar, kostot e çmontimit dhe lëvizjes së aktiveve dhe kthimin e vendodhjes së tyre në gjëndjen e mëparshme, si dhe kostot e kapitalizuara të huave. Kostot gjithashtu mund të përfshijnë zëra të transferuar nga të ardhurat të tjera përmbledhëse për fitime apo humbje të kualifikimit të flukseve të parasë të mbuluara nga blerjet në monëdhë të huaj të aktiveve afatgjata materiale. Blerja e programeve kompjuterike të cilat janë pjesë përbërëse e funksionimit të paisjeve përkatëse kapitalizohet si pjesë e asaj paisjeje. Në momentin që një nga aktivitet afatgjata materiale përbëhet nga pjesë me jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato rregjistrohen si pjesë të ndara nga njëra tjetra. Fitimet ose humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale percaktohen duke krahasuar arkëtimet nga shitja me vlerën kontabël neto të aktivitet afatgjatë material dhe njihen neto në të ardhura ose humbje të tjera.

Kostot në vijim

Kostot për zëvendësimin e një pjese të aktivitet afatgjatë material rregjistrohen me vlerën kontabël të aktivitet në rast të është e mundur që përfitimet ekonomike në periudhat e ardhshme të përfshira në të të mund të rrjedhin tek shoqëria dhe kostoja të mund të matet me besueshmëri. Vlera e kontabël e pjesëve të ndërtuara si rrjedhojë ç'rregjistrohet. Kostoja e shërbimit ditor, të vazhdueshëm të ndërtesave dhe paisjeve rregjistrohet tek fitimet ose humbjet kur ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi llogaritet mbi vlerën e amortizueshme e cila është kostoja e aktivitet ose cdo kosto tjetër zëvendësuese minus vlerën e mbetur. Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse bazuar në metodën e vlerës së mbetur për paisjet e zyrës me një normë amortizimi vjetore prej 20%, për paisjet informatike 25% dhe për makinat e transportit 20%. Kjo mënyrë pasqyron më përfaqësi trendin e konsumit të përfitimeve të ardhshme ekonomike të përfshira në këto aktive. Përmirësimet e aktiveve të marra me qera amortizohen me 20%. Aktivitet në proces nuk amortizohen. Nëse normat e amortizimit dhe vlerat e mbetura, nuk janë të parëndësishme, aktiveve afatgjata materiale rivlerësohen në datën e raportimit.

(e) Aktivitet afatgjata jomateriale

Njohja dhe matja

Aktivitet jomateriale të blera nga shoqëria maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe rënien në vlerë të akumuluar. Emri i mirë është njohur në datën e marrjes së kontrollit për shoqëritë e blera Shega Oil, Albaskan Trucks & Buses, Shega Air dhe Shega Podgorice. Emri i mirë njihet me vlerën e tejkalimit të investimit ndaj vlerës neto të aktiveve të shoqërive të blera në datën e blerjes (transferimit të kontrollit)

Kostot në vijim

Kostot në vijim kapitalizohen vetëm kur ato rrisin përfitimet e ardhshme ekonomike nga aktivitet specifik me të cilat lidhen. Të gjitha shpenzimet e tjera, duke përfshirë shpenzimet e gjenerimit të emrit të mirë dhe markës,

SHEGA TRANS SH.A.
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE TE KONSOLIDUARA
PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2016

(Vlerat janë të shprehura në Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

njihen në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse (në humbje ose fitime) në momentin e ndodhjes. Emri i mire pas njohjes fillestare testohet cdo vit nese ka indikatore per renie ne vlere.

4. Përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(e) Aktivet afatgjata jomateriale (vazhdim)

Amortizimi

Amortizimi llogaritet mbi koston e aktiveve, ose cdo vlerë tjetër të konsideruar si kosto, minus vlerën e mbetur. Amortizimi njihet në të ardhura ose shpenzime duke përdorur metodën e vlerës së mbetur me një normë vjetore amortizimi 25% për programet kompjuterike. Per Emrin e Mire Grupi nuk mendon se ka indikatore per renie vlere.

(f) Rënia në vlerë

Aktivitet financiare

